



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 115, datë 27.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2 165 523 (DY MILION E NJËQIND
E GJASHTËDHJETË E PESËMIJË E PESËQIND E NJËZET E TRE) LEKË PËR
BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT EUSAIR 4 YOUTH**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Turizmit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 2 165 523 (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë për bashkëfinancimin e projektit EUSAIR 4 youth.
2. Efekti financiar do të përballohet nga të ardhurat shtesë të bashkisë Durrës, zëri “sponsorizim”, të ardhura të rimbursuara nga projekti POWER, programi i BE Interreg ADRION 2014-2020.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834 prot.
6

Durrës, më 08 / 11 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.115 datë 27.10.2022 :

“Për miratimin e përdorimit të fondit prej 2.165.523 (dymilion e njëqind e gjshtëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë për bashkëfinancimin e projektit EUSAIR 4 YOUTH”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

